



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

URDHRI PROFESIONAL HIDROTEKNIK

MISIONI DHE VIZIONI

MISIONI DHE VIZIONI

Profesionisti Hidroteknik ka pasur dhe vazhdon të ketë një rol tepër të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërisë, duke zhvilluar aktivitetin në qendër të ekonomisë duke përdorur në mënyrë racionale edhe të qëndrueshme të mirat materiale të ardhura nga vetë natyra, të pasurive natyrore me qëllim përfitim, si edhe duke shfrytëzuar fenomene dhe dukuri të natyrës për t'i transformuar ato në materiale e dukuri të tjera.

Në zbatimin e komponentëve të Riskut, Urdhri i Inxhinierit Hidroteknike ka në konsideratë qëllimin e përgjithshëm të zhvillimit të veprimtarisë së Disiplinës së Hidroteknikës në të gjitha nivelet e shërbimeve që kryejnë inxhinieret hidroteknike si edhe të vete institucionit të Entit Publik. Gjithashtu do të merren në konsideratë dhe disa iniciativat dhe projekte të së ardhmes. Në Planin Strategjik të Zhvillimit të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknike, ka një analizë të hollësishme të mjedisit strategjik, ku Urdhri nëpërmjet Inxhinierëve Hidroteknike kryen dhe parashikohet të kryejë veprimtarinë në të ardhmen. Njëkohësisht ky Plan përcakton drejtimit kryesorë drejtë zhvillimit të qëndrueshëm të veprimtarive të Disiplinës së Hidroteknikës. Misioni, vizioni dhe vlerat janë pjesa e rëndësishme e Strategjisë, të cilat mbështesin objektivat strategjike të Urdhrit, si më poshtë:

- Zhvillimi i Veprimtarisë Administrative të Entit Publik të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik në RSH-se, në përputhje me standardet vendase, ndërkombëtare dhe praktikën e mira për të lehtësuar dhe shpejtuar çdo proces.
- Rritja e kapaciteteve të shërbimeve të veprimtarisë së disiplinës së Hidroteknikës, në përputhje me nevojat e shërbimeve në treg dhe me standardet e sigurisë dhe shëndetit dhe zhvillimit ekonomik.
- Urdhri do të zhvillojë edukim të vazhdueshëm profesional gjatë karrierës dhe do të sigurojë mundësi për zhvillim profesional për ata inxhinierë/specialist dhe nën specialist që kanë mbikëqyrje, si edhe vlerëson performancën e inxhinierëve dhe specialistëve që kanë mbikëqyrje.
- Urdhri ka të drejtën e certifikimit të profesionistëve të nivelit të lartë të inxhinierëve hidroteknikë, si edhe ushtron të drejtën e vlerësimit, kategorizimit dhe pajisjes me dëshmi

profesionale të specialisteve të nivelit jo inxhinier që punojnë në fushat e veprimtarisë së hidroteknikës.

- Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik ne RSH nëpërmjet vendimeve të Asamblesë Kombëtare synon rritjen e vlerësimit financiar të çdo inxhinier hidroteknike, specialist apo nën specialist plotësues, si edhe të shoqërive të tyre që do të ushtrojnë shërbime. Shpërblimi i Pagës Bruto të Inxhinierit Hidroteknik, si edhe të vlerës së tarifave të shërbimeve me qëllim për të kryer punë efektive dhe cilësore minimalisht vlerësohet.
- Zgjidhjes së konflikteve profesionale nga Urdhri, do të behet nëpërmjet procedurës së gjyimit profesional. Pranë Urdhrit do të funksionoj Komisioni i Ankimit të Shërbimit Profesional, si organizëm i gjyimit profesional dhe do të shqyrtoj kërkesat për ankim të shërbimit profesional të karakterit teknik në fushën e veprimtarisë hidroteknike, lidhur me shërbimin e kryer për “Mbikëqyrje dhe Kolaudim”, për “Vlerësim dhe Ekspertizë Teknike”.
- Ndikimi në evazioni profesional dhe evazionin fiskal, ndaj çdo sjelljeje ose veprimi të inxhinierëve hidroteknik apo personave fizikë/juridik si edhe specialistëve të nivelit jo inxhinier, si edhe personave jo kompetent në fushën e veprimtarisë hidroteknike, i drejtohen ankesa ose kërkesa Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik. Për shqyrtimin e kërkesave/ankesave për procedim administrativë, pranë Urdhrit funksionon Komisioni Etikës dhe Gjyimit Disiplinor Profesional, i cili është organ i gjyimit disiplinor profesional.
- Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik ne RSH nëpërmjet inxhinierëve hidroteknike synon të nxisë dhe të inkurajoj dhe të rekrutoj student me qëllim edukimin e nivelit të mesëm dhe të lartë universitare në inxhinierinë hidroteknike. Inxhinieri Hidroteknik ka për detyrim të trashëgojë profesionin.